



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Fonetikë e gjuhës ruse

Ngarkesa: 4 kreditë, 15 leksione, 25 seminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhë ruse”

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të njohë studentin me strukturën fonetike të gjuhës së sotme ruse, si bazë për zhvillimin e kompetencave gjuhësore. Të formojë njohuri të përgjithshme mbi ortoepinë dhe intonacionin e gjuhës letrare ruse. Të zhvillojë aftësi praktike për analizën fonetike dhe fonologjike të materialeve gjuhësore në rusisht. Të ndërtojë bazën teorike për kuptimin dhe përvetësimin e disiplinave ndihmëse si grafika, ortografia dhe ortoepia.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësojë studentin për analizën akustike, artikulative dhe funksionale të tingujve të gjuhës ruse.
2. Të formojë shprehje të sakta të shqiptimit dhe të përdorimit të mjeteve fonetike, përmes praktikave me transkriptim dhe analizë të ligjëritimit të folur.
3. Të mësojë rregullat e intonacionit dhe përdorimin e tyre në komunikimin e gjuhës letrare ruse.
4. Të inkurajojë punën e pavarur dhe studimin krahasues e klasifikues të dukurive fonetike, si pjesë e zhvillimit profesional të studentit

Rezultatet e pritshme.:

Përvetësimi i programit të kësaj lënde i jep mundësi studentit:

1. Të dijë të klasifikojnë zanoret dhe bashkëtingëlloret;
2. Të diferencojë dhe të interpretojë proceset fonetike;
3. Të bëjë transkriptimin e një fjale, fjalie, teksti;
4. Të përmirësojë shprehjet e tij të shqiptimit dhe intonacionit, të fituara në fillim të mësimin të gjuhës së huaj;
5. Të shprehë mendimet e tij për një sërë çështjesh lidhur me studimin e kësaj disipline;